



Rregullat e distancës për nxënëse, nxënës dhe tërë personelin pedagogjik, administrativ e mbështetës:

- ✓ Unë e respektoj gjithmonë rregullën e distancës minimale prej 1.5 metra – përdorimi në vazhdimësi i maskës nuk më përjashton nga ky rregull.
- ✓ Ideja themelore: Unë shkoj në shkollë me qëllim që të mësoj, dhe jo për t'i takuar shoqet/shokët e mi, ku kontakti nuk do të thyejë rregullën e distancës prej 1.5 m.
- ✓ Unë i përmbahem rregullave të shkollës dhe i ndjek e i zbatoj të gjitha udhëzimet nga kujdesari im, mësimsdhënësit, kujdestarët e ditës, menaxhmenti i shkollës dhe i gjithë stafi mbështetës.
- ✓ Unë veçse e kam në konsideratë ndalesën e përdorimit të celularit në tërë objektin/hapësirën e shkollës, duke përfshirë edhe oborrin e shkollës.
- ✓ Unë nuk vij në shkollë me simptoma/shenja të ftohjes: Kollitje, ethe, temperaturë, kokëdhimbje, dhimbje fyti, plogështi etj. Për këtë, prindi im e lajmëron kujdestarin tim në kohë.
- ✓ Në pushime të gjata ose të shkurtra, unë nuk luaj futboll e as ndonjë lojë tjetër, që kërkon të ketë kontakt fizik brenda 1.5 m.
- ✓ Unë nuk mund të qëndroj në kohë të lirë para tabelave të shpalljeve, siç e kemi zakon të qëndrojmë dhe të shikojmë në to, kjo për shkak të grumbullimit të nxënësve dhe të tjerëve. Më mirë pres jashtë në oborr dhe e zë momentin kur nuk ka grumbull nxënësish dhe të tjerë.
- ✓ Unë pres sinjal nga kujdestarët ditorë për të hyrë në shkollë.
- ✓ Unë në rresht e mbaj distancën, përpara dhe anash, në largësi prej 1.5 m. dhe në asnjë mënyrë nuk e thyej këtë rregull. Gjithmonë pres të hyjnë të tjerët dhe kështu i jap përparësi zvogëlimit të grumbullimit të nxënësve.
- ✓ Unë, duke filluar nga tash, e var xhaketen mbi karrigen time dhe jo në vendin e caktuar për to para derës.
- ✓ Ushqimin e marr nga shtëpia dhe kujdesem të jetë dietik. Një shishe ujë do të më përcjellë tërë ditën në shkollë.
- ✓ Unë kujdesem të mos hyj në banjo të shkollës, në rast se ka më shumë se katër nxënëse/nxënës.
- ✓ Unë pres në radhë para shiritave/ shenjzuesve të vendosur para banjos, këtë e bëj për vete dhe të tjerët.
- ✓ Unë i laj duart e mia rregullisht me shampon për 30 sekonda. Kësaj (larjes së duarve) i jap përparësi në krahasim me atë të përdorimit të dezinfektantit.
- ✓ Unë jam vetë përgjegjës për sigurimin e maskës mbrojtëse. Atë e vendos gjithëherë dhe në mënyrën e duhur, duke mbuluar hundën dhe gojën.
- ✓ Unë nuk i jap dorën askujt, nuk përqafohem me askë, refuzoj kontaktin fizik me të gjithë.
- ✓ Unë jam i vetëdijshëm që nuk do të ketë punë partnere dhe grupe.
- ✓ Unë e di që nuk mund t'i shkëmbej mjetet e shkollës me nxënësit e klasës sime dhe të klasave të tjera, prandaj unë kujdesem që t'i kem gjithmonë ato me vete.
- ✓ Unë kujdesem për higjienën personale dhe të hapësirës në klasë, sipas rregullave që më prezantojnë mësimsdhënësit e mi.
- ✓ Ne, gjatë kohës së mirë (kohës së nxehtë dhe me diell) i bajmë dritaret hapur, ndërsa kur fillon vjeshta dhe dimri i ajrosim klasat tona, çdo 30 minuta. Këtë e bëjmë në konsultim/pajtim me profesoreshat/profesorët tona/tanë.
- ✓ Nëse kam punë në administratë, apo më duhet të konsultohem me ndonjë mësimsdhënës/mësimsdhënëse tim/time, këtë e bëj duke pritur në radhë dhe duke respektuar distancën e shenjzuar përmes shiritave në dysheme.

Këto rregulla janë pjesë e kodit të disiplinës në shkollën „Loyola-Gymnasium“, andaj si të tilla janë obligative për të gjithë.